

# Plan i veprimit, Ndhimë për Fëmijët dhe Familjet në Situatë Rruge, Bashkia Shkodër

## Përmbajtja e dokumentit

1. Shkurtime
2. Referencat Ligjore të Planit
3. Konceptet dhe përkufizimet kryesore
4. Parimet në të cilat mbështetet hartimi dhe zbatimi i planit
5. Matrica e Planit
6. Aneks : Kornizë analize për hartimin dhe zbatimin e planit ndihmë për fëmijët dhe familjet në situatë rruge

## 1.Shkurtime

ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
BSH	Bashkia Shkodër
DSHSSHP	Drejtoria e Shërbimeve Sociale , Strehimit dhe Shendetit Publik Bashkia Shkodër
GK	Grupet komunitare që veprojnë në Shkodër
GTG	Gruaja te Gruaja
GZH	Gruaja në Zhvillim
KBSH	Kryetari i Bashkisë Shkodër
Malteser	Malteser

MB	Ministria e Brendshme
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
PMF/SH	Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve Bashkia Shkodër
PSH	Prefektura Shkodër
PV	Plani i Veprimit për Fëmijët 2012-2015
QZH	Qendra e Zhvillimit
SHF/18	Shtëpia e Fëmijës deri 18 vjec
SHF/6	Shtëpia e Fëmijës deri 6 vjec
SHF / 3	Shtëpia e Foshnjës deri 3 vjec
ST-Sh	Skuadra e Terrenit për Identifikimin, Ndihmën dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Ruge Shkodër
SC	Save the Children
SOS	Fshati SOS
UDH	Udhëzues i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Udhëzues i Procedurave për Identifikimin, Ndihmën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Ruge” 25.02.2015
UDH-10	Udhëzim Nr 10, datë 25.02.2015 i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Arsimit dhe Sportit , ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Punëve të Brendshme për Mënyrat, Format e Bashkëpunimit dhe Procedurat e Ndërhyrjes në Ndihmë të Fëmijëve në Rrezik për Institucionet dhe Strukturat Kryesore Përgjegjëse për Mbrojtjen e Fëmijës
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
SV	Save the Children
WV	World Vision

ZRSHSSSHSH	Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër
PSH	Projekti Shpresa
PGXXIII	Pappa Giovanni XXXIII
SHFR	Shtëpi Familje Ravasco
MDG	Maddonina dell Grappa

## 2.Referencat Ligjore të Planit

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe Protokolli shtesë i KDF për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës;
- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokolli Shtesë mbi ‘Parandalimin, shtypjen, dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve;
- Konventa e ILO lidhur me Ndalimin dhe Veprimin e Menjëhershëm për Eliminimin e Formave më të këqija të punës së fëmijëve ( C182);
- Konventa e ILO për Moshën Minimale (C138);
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë ;
- Ligji Nr.10 347, datë 4.11.2010, “ Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”;
- Ligj Nr. 108/2014 “ Për Policinë e Shtetit” ;
- Ligj Nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “ ;
- Memorandumi i Mirëkuptimit i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Europë në Shqipëri (OSCE) “Për Promovimin dhe Zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm”, datë 07/02/2007;
- VKM Nr. 582, datë 27.07.2011, “ Për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit;

- Udhëzim Nr 10, datë 25.02.2015 i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Arsimit dhe Sportit , ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Punëve të Brendshme për Mënyrat, Format e Bashkëpunimit dhe Procedurat e Ndërhyrjes në Ndhimë të Fëmijëve në Rrezik për Institucionet dhe Strukturat Kryesore Përgjegjëse për Mbrojtjen e Fëmijës<sup>1</sup>;
- VKM 438, datë 2.7.2014, Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014 - 2020;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 691, datë 29.7.2015 për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 ;
- VKM Nr. datë ... Planit të Veprimit për Fëmijët 2012-2015<sup>2</sup>
- Udhëzues i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Udhëzues i Procedurave për Identifikimin, Ndhimën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Rruge” 25.02.2015.
- Urdhri i Ministrit të brendshëm për procedurat e rregjistrimit të fëmijëve të parregjistruar

### 3. Konceptet dhe Përkufizimet Kryesore

**Grupet e Rrezikuara për Përrjashtim Social:** Sipas Planit të Veprimit për Fëmijët 2012-2015 grupe të fëmijëve të konsideruara “ më të rrezikuar për përrjashtim social”janë: **Fëmijët e familjeve më të varfra:** Fëmijët familjet e të cilëve jetojnë me ndihmë ekonomike janë më të rrezikuarit nga përrjashtimi social. Ato vuajnë nga disavantazhe të shumëfishta sociale pasi kanë vështirësi në marrjen e shërbimeve bazë si strehimi, edukimi, shërbimet shëndetësore dhe mbrojtja shoqërore. **Fëmijët pa kujdes prindëror:** Analiza e të dhënave mbi numrin e fëmijëve të vendosur në institucione, si dhe dinamika e hyrjes dhe daljes nga këto institucione tregon se afërsisht 60 përrqind e fëmijëve vijnë nga familje të varfëra ose familje me probleme sociale, 35 përrqind prej tyre janë të braktisur që në lindje dhe 5 përrqind e tyre janë të vendosur në institucione për arsye të tjera, përrfshi këtu riatdhesimin e fëmijëve të trafikuar dhe fëmijët që punojnë. **Fëmijë me aftësi të kufizuara:** Nga të dhënat administrative mund të njihet vetëm numri i individëve të cilët përrfitojnë pagesë paaftësie sipas llojit të paaftësisë: mendore, fizike, pamësore apo dëggjimore. Mbështetur në analizën e të dhënave të përrftuara nga dokumentat administrative rezulton se afro 60 përrqind e fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në zonën rurale. **Fëmijët që detyrohen të punojnë:** Në nivel kombëtar informacioni i saktë mungon, por së shpejti pritet një studim i INSTAT. Studimet lokale tregojnë se rreth dy të tretat e fëmijëve që punojnë në rrugë e kanë braktisur shkollën, kurse 35 përrqind e ndjekin atë me ndërprerje. Pranohet se një pjesë e konsiderueshme e familjeve rome dhe egjiptiane, u kërkojnë fëmijëve të punojnë për të ndihmuar familjen

<sup>1</sup>Këtu e më poshtë si Udhëzimi Nr.10

<sup>2</sup> Këtu e më poshtë referuar si PV

**Niveli i rrezikut të fëmijëve:** “Niveli i rrezikut” lidhet me nivelin e abuzimit dhe me rrezikun ndaj zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës. Përcaktimi i nivelit të rrezikut bëhet në bazë të vlerësimit të situatës ku ndodhet fëmija në momentin e identifikimit si dhe pas procesit të vlerësimit gjithëpërfshirës.<sup>3</sup> Sipas Udhëzimit Nr. 10 rreziku klasifikohet në **Rrezik i ulët:** Fëmija është disi i sigurt dhe ka aftësi për të mbrojtur vetveten. Fëmija nuk është plagosur, ose është plagosur shumë lehtë në pjesë të trupit të cilat nuk prekin pjesët jetësore, si p.sh.gjunjtë, duart etj. Plagosja mund të ketë ndodhur një herë të vetme dhe nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm te fëmija.Fëmija mund të ndjekë si zakonisht shkollën, dhe mezi pret të shkojë në shtëpi në fund të ditës.Prindi/Kujdestari ka gatishmërinë dhe kapacitetin të përkujdeset për fëmijën dhe dëshiron të mësojë praktika pozitive prindërimi.**Rrezik i mesëm-** fëmija është i vogël, ka aftësi të kufizuara vetëmbrojtëse (për shembull mund të ketë një vonesë në zhvillim) ose mund të ketë nevojë për përkujdesjen e një të rrituri. Fëmija është plagosur pak (në zona të rëndësishme të trupit), dhe prindi/kujdestari njihet për ndëshkime dhe disiplinë strikte.Fëmija mbetet vazhdimisht mbrapa në mësim dhe mund të ketë vështirësi në sjellje.Prindi/Kujdestari kanë vështirësi për të kontrolluar sjelljen e tij (për shembull, për shkak të çrregullimeve emocionale), dhe mund të shfaqin pikëpamje dhe mendime të paqën-drueshme lidhur me dëshirën e tyre për të ndryshuar stilin e prindërimit.Abuzimi seksual pa kontakt mund të klasifikohet si rrezik i mesëm.**Rrezik i lartë-** fëmija nuk është në gjendje të kujdeset për veten e tij, ose për arsye të ndryshme mund të ketë kapacitete të ulëta për t’u kujdesur për veten.Abuzuesi ka plagosur fëmijën në pjesë jetësore të trupit duke përfshirë kokën, qafën dhe organet riprodhuese.Sjellja e abuzuesit bën që fëmija të kërkojë rregullisht ndihmën mjekësore ose të kërkojë shtrimin në spital. Abuzuesi nuk ka dëshirë të ndryshojë stilin e tij/të saj edukativ që mund të ketë lidhje edhe me drogën, alkoolin ose sëmundje psikologjike dhe/ose nuk mund të garantojë që do të ketë ndryshim në sjelljen e tij/saj, pavarësisht premtimit për një ndryshim të tillë. Abuzuesi njihet si një person që dëmton fëmijën.Fëmija është i frikësuar nga prindi/kujdestari i tij dhe për këtë arsye mund të largohet nga shtëpia.Fëmija mund të ketë probleme serioze në sjellje, për shkak të arsyeve familjare, ose nuk mund të jetë në gjendje të ndjekë shkollën.Abuzuesi ka kontakt të rregullt me fëmijën dhe nuk ka persona të tjerë në familje të cilët mund të luajnë rolin e kujdestarit kryesor.Të gjitha abuzimet seksuale me kontakte fizike klasifikohen si raste me rrezik të lartë.**Rrezik i menjëhershëm-** Fëmija nuk ka aftësinë që të kujdeset për veten në mënyrë të pavarur dhe nuk ka aftësi vetëmbrojtëse.Fëmija është tërësisht nën kujdestarinë e abuzuesit dhe nuk ka ndonjë kujdestar tjetër.Abuzuesi njihet si një dhunues ose abuzues seksual ose ka shprehur synimin për ta dëmtuar fëmijën më tej. Është e sigurt që kthimi në shtëpi do të bëjë që fëmija të plagoset përsëri. Fëmija nuk ka dëshirë të kthehet në shtëpi ose mund të jetojë jashtë shtëpisë ose pa mbikëqyrjen e të rriturve (siç është rasti i fëmijëve që jetojnë në rrugë).Në zbatim të vendimit nr.265 datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave rastet në rrezik të menjëhershëm konsiderohen “raste emergjente”.

**Fëmijë në situatë rruge:** i referohet fëmijëve që kanë një lidhje me rrugën, zakonisht për arsye se ata punojnë dhe/ose jetojnë në rrugë, qoftë kjo në baza të përkohshme ose sezonale. Këta fëmijë kryesisht përfshijnë: Fëmijë në situatë lypje, vetëm, bashkë me të tjerë ose të mbajtur në krahë, të cilët mund të ofrojnë objekte ose shërbime për një pagesë simbolike; Fëmijë të përfshirë në punë informale në rrugë si p.sh. mbledhja e materialeve plastike ose metali për riçikim, ose shitës ambulantë; Fëmijë që shesin

---

<sup>3</sup> Udhëzues i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Udhëzues i Procedurave për Identifikimin, Ndihmën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Rruge” 25.02.2015

materiale në semafor, në kafene, restorane ose në vende të caktuara në anë të rrugës, ose ofrojnë shërbime si parkim makinash, portier ose pastrim këpucësh; Fëmijë të shfrytëzuar seksualisht për qëllime përfitimi ekonomik; Fëmijë në konflikt me ligjin, të cilët janë të përfshirë në krime rruge si transportimi dhe/ose shitja e drogave.<sup>4</sup>

## 4.Parimet kryesore në të cilat mbështetet plani

Parimet kryesore në të cilat mbështetet plani I Bashkisë Shkodër janë parimet e shprehura në Udhëzues i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Udhëzues i Procedurave për Identifikimin, Ndihmën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Ruge” 25.02.2015 dhe specifikisht :

- ✓ ***Mbrojtja e interesit më të lartë i fëmijës*** - Të gjitha veprimet, masat dhe vendimet që do të merren gjatë procesit të Identifikimit, Ndihmës së Menjëhershme dhe Referimit të Fëmijëve në Situatë Ruge duhet të kenë si konsideratë kryesore interesin më të lartë të fëmijës.
- ✓ ***Qasje e bazuar tek të Drejtat e Fëmijës*** Të gjithë fëmijët pa asnjë dallim gëzojnë të drejta të patjetërsueshme dhe përgjegjësi që burojnë nga këto të drejta. Të gjithë fëmijët, pavarësisht gjendjes së tyre ekonomike, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, kombësisë, përkatësisë etnike, kategorisë sociale, aftësisë së kufizuar, apo çdo lloj statusi tjetër kanë të drejta të barabarta dhe kanë të drejtë të mbrohen njëllor nga Shteti. Nisur nga ky parim, fëmijët në situatë ruge nuk duhen parë si një problem social por si qenie njerëzore, me potencial për të dhënë kontributin e tyre për zhvillimi pozitiv shoqërisë. Ata duhet të aftësohen për të marrë pjesë aktive në të gjitha çështjet që u përkasin atyre dhe duhet të fuqizohen që të ngrenë zërin për zbatimin e plotë të të drejtave të tyre. Modelet më të sukseshme të mbrojtjes janë ato me në qendër fëmijën. Fëmijët duan t’u merret mendimi, të trajtohen me respekt, të kenë marrëdhënie të qëndrueshme me profesionistët te ngritura në mirëbesim dhe vazhdimësi. Prandaj të gjitha veprimet dhe hapat që do të ndiqen për mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge, duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e tyre të mirëfilltë në hartimin, zhvillimin dhe vlerësimin e tyre.
- ✓ ***Mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi e të gjithëve:*** Ata që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët si: mësuesit dhe edukatorët, mjekët, infermierët, policia e shtetit, punonjësit socialë, psikologët e shkollave, punonjësit e organizatave jo-qeveritare, ofruesit vullnetarë të shërbimeve, administratorët shoqërorë, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, etj., kanë përgjegjësi të njëjtë për të mbrojtur fëmijët. Ky parim bazohet gjithashtu tek fakti se asnjë profesionist i vetëm nuk mund të ketë një pamje të plotë të gjithë situatës dhe nevojave të fëmijës. Për këtë arsye, kushdo që është në kontakt me fëmijën duhet të luajë një rol aktiv në identifikimin e problemit, gjetjen e zgjidhjeve dhe dhënien e ndihmës konkrete në formë të koordinuar

---

<sup>4</sup> MMSR, UNICEF & Save the Children. “Studimi Kombëtar mbi Fëmijët në Situatë Ruge në Shqipëri”, Prill 2014

dhe bashkëpunuese. Të gjitha institucionet dhe profesionistët në mënyrë që të punojnë në mënyrë efektive duhet të njohin dhe të kenë të qarta rolet e tyre dhe ato të profesionistëve të tjerë me të cilët duhet të bashkëpunojnë.

- ✓ **Çdo fëmijë dhe situata e tij/saj është e veçantë:** Puna me fëmijët në situatë rruge duhet të udhëhiqet nga parimi se ky grup fëmijësh nuk është homogjen por ka në përbërje të tij disa tipologji fëmijësh. Ky parim merr në konsideratë faktin se shkaqet që detyrojnë fëmijën të ndërtojë lidhje me rrugën dhe faktorët që e shtyjnë atë për të mbajtur këto lidhje janë të shumta dhe ndryshojnë nga njëra situatë në tjetrën. Ajo që pranohet gjerësisht është se shumica e këtyre fëmijëve kanë vuajtur nga dhunimi i shumëfishtë i të drejtave të tyre në shtëpi ose në mjedisin familjar përpara se të zhvillojnë një lidhje me rrugën. Prandaj çdo ndërhyrje që targeton fëmijët në situatë rruge duhet të marrë në shqyrtim të hollësishëm situatën individuale të çdo fëmije, për të kuptuar historinë e lidhjes me rrugën, pasojat e privimit të shumëfishtë që ata përjetojnë dhe për të hartuar ndërhyrje të posaçme sipas nevojave unike të çdo fëmije.
- ✓ **Familja dhe re-integrimi si prioritet i parë** Familja duhet të jetë prioriteti i parë që merret në konsideratë sa herë që punohet për hartimin e planeve afatgjata për mbrojtjen dhe reintegrimin e fëmijëve në situatë rruge, në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës. Familja mbetet mjedisi natyral për rritjen, mirëqënien dhe mbrojtjen e fëmijës prandaj duhen bërë të gjitha përpjekjet për ta fuqizuar familjen dhe përgatitur terrenin që fëmija të qëndrojë ose të rikthehet me prindërit ose kur nuk është e mundur me të afërmit e tij/saj. Konsiderata e largimit të fëmijës nga familja do të zbatohet vetëm në ato raste kur prindërit biologjikë dhe/ose të afërmit konsiderohen se përbëjnë rrezik për sigurinë dhe mirëqënien e afatgjatë të fëmijës.

## 5. Matrica e Planit

### 5.1 Parandalimi

**5.1.1 Njohja e shkaqeve të fenomenit të fëmijëve në situatë rruge përfshirë mangësitë në legjislacionin vendor apo sfidat në funksionimin e institucioneve vendore**

Aktivitetet për arritjen e objektivit	Kosto mujore dhe mbulimi	Përgjegjës kryesor	Mbështetës	Afati/Shpeshësia	Treguesit	Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshësia e monitorimit	Institucioni/përgjegjësi e monitorimit
Takime me fokus analizën vendore e shkaqeve bazuar në të dhënat e përfituara nga rastet konkrete të fëmijëve në situatë rruge të trajtuara në Bashkinë Shkodër.	Nuk ka nevojë për buxhet, takimet koordinohen dhe zhvillohen në Bashki.	Punonjësja e mbrojtjes së fëmijëve.	Institucionet & organizatat	Brenda 2016, 3 takime të realizuara.	Raportet e takimeve. Rekomandimet e nxjerra për masa dhe ndryshime në legjislacionin vendor	Shqyrtimi i dokumentacionit të rasteve dhe raporteve të takimeve	Drejtori/Shefi i Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkodër
Vlerësim i situatës së përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve, dhe draftimi i planit të mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Shkodër	Buxheti nga OSBE, Save the Children	BSH	OSBE , Save the children	Brenda 2016	Raporti i vlerësimit të situatës. Draft plan i mbrojtjes së fëmijëve	Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit	BSH, OSBE, Save the children,
Takime me prindërit në komunitete/ ambjente neutrale për informim për të drejtat dhe objekti i punës së skuadrave të terrenit	30000 për tre muaj	Koordinatori i skuadrave të terrenit	Organizatrat	2 takime në muaj	Raportet e takimeve.	Shqyrtimi i dokumentacionit të rasteve dhe raporteve të takimeve	Drejtori/Shefi i Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkodër, Organizatat
Fushatë sensibilizuese në shkolla 9-vjeçaredhe të mesme në territorin e Bashkisë Shkodër	S'ka	DSHSBSH	DAR, Organizatat	Maj - Dhjetor 2016	Materialet sensibilizuese, raportet dhe dokumentacioni i aktiviteteve	Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit,	BSH, ASHMDF
Shfaqja në stacionin 8ocal televiziv e deklaratave të autoriteteve në angazhim për fëmijët në 8ocale8 rruge dhe rasteve të suksesshme	S'ka	DSHSBSH	Televizionet lokale	Sipas mundësive	Kronika të lajmeve	Monitorim I mediave	BSH



## 5.2.2 Mbrojtja

### 5.2.1 Vendosija dhe forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial për të realizuar ndërhyrje të koordinuara multi-disiplinare në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge dhe ndihmë të familjeve të tyre

Nënobjektivi: Vlerësimi dhe planifikimi i kapaciteteve të angazhimit 9ocal për fëmijët në 9ocale9 rruge ( baseline)

Aktivitetet për arritjen e objektivit	Kosto mujore dhe mbulimi	Përgjegjës kryesor	Mbështetës	Afati/Shpeshhtësia	Treguesit	Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshhtësia e monitorimit	Institucioni/përgjegjësia e monitorimit
Përgatitja e draft planit fillestar nga Bashkia Shkodër.	S'ka	BSH	Organizatet dhe institucionet vendore	Janar – Shkurt 2016	Draft plani fillestar I ndarë me ASHMDF	Shqyrtimi I planit fillestar	BSH, ASHMDF
Seminar me aktorët e mbrojtjes së fëmijëve për shqyrtimin dhe zhvillimin të mëtejshëm të planit fillestar bazuar në udhëzimin dhe eksperiencën.	Seminar i realizuar, kostot janë mbuluar.	BSH	ASHMDF, OSBE Organizatet dhe institucionet 9ocale	Mars 2016	Pjesëmarrja në seminar  Niveli I përfaqësimit;  Draft Plani	Shqyrtimi I raportit dhe dokumentacionit të seminarit.	ASHMDF, BSH
Caktimi i pikave/punonjësit të kontaktit për çdo institucion 9ocale dhe privat të përfshirë në zbatimin e planin të hartuar	S'ka	BSH  Institucionet dhe agjencitë hartuese të planit dhe angazhuara me zbatimin e tij	BSH, organizatat dhe institucionet vendore në BSH.	Mars 2016	Kërkesa  Lista e detajuar e kontakteve.	Shqyrtimi I dokumentacionit.	BSH

Komunikime me aktorët vendorë dhe qëndrorë për finalizimin e planit	S'ka	BSH	ASHMDF OSCE Organizat dhe institucionet 10ocale	Mars – Prill 2016	Pjesëmarrja në seminar  Niveli I përfaqësimit;  Listprezenca  Konkluzionet mbii draft planin	Shyqrtimi i dokumentacionit.	BSH
Miratimi I planit nga Këshilli I BSH	S'ka	Drejtoria e Shërbimeve Sociale BSH		Maj 2016	Vendimi I Këshillit të BSH  Buxheti I miratuar	Shyqrtimi i dokumentacionit.	BSH , AMSHDF
Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve me organizatat dhe institucionet vendore zbatuese të planit, përfshirë takime të KBSH me Kryesuesit e Gjykatave dhe Prokurorive të të dy niveleve.	S'ka	Drejtoria e Shërbimeve Sociale BSH	BSH, organizatat dhe institucionet vendore në BSH.	Brenda Qershorit 2016	Marrëveshjet e lidhura.	Shyqrtimi i dokumentacionit.	Këshilli Bashkiak
Takime periodike me institucionet dhe organizatat e përfshira në identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge	S'ka	Drejtoria e Shërbimeve Sociale BSH	GTM, Organizatat dhe institucionet vendore	Çdo 2 muaj	Minutat e takimeve	Shyqrtimi i dokumentacionit.	BSH
Trajnim me administratorët shoqërorë, dhe punonjësit e tjerë që do të punojnë direct për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge	Donatorët për 2016	Drejtoria e Shërbimeve Sociale BSH	OSBE, Save the Children, Organizatat	Prill Maj 2016	List prezenca, modulet dhe raportet e trajnimeve	Shyqrtimi i dokumentacionit.	BSH, ASHMDF

Workshope reflektuese ndërmjet gjithë aktorëve	S'ka	Drejtoria e Shërbimeve Sociale BSH	OSBE, Save the Children, Organizatat	çdo 3 muaj	List prezenca, raportet e workshopeve	Shqyrtimi i dokumentacionit.	BSH, ASHMDF
<b>Nënobjektivi: Krijimi i dhe funksionimi i skuadrës së terrenit</b>							
<b>Aktivitetet për arritjen e objektivit</b>	<b>Kosto mujore dhe mbulimi</b>	<b>Përgjegjës kryesor</b>	<b>Mbështetës</b>	<b>Afati/Shpeshësia</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshësia e monitorimit</b>	<b>Institucioni/përgjegjësi e monitorimit</b>
Ngritja e skuadrave të terrenit me punonjës të bashkisë dhe punonjës nga organizatat  Përcaktimi i koordinorit të skuadrave	S'ka	Drejtori i DSHSSHB  Organizatat dhe institucionet me të cilat është lidhur marrëveshje.		Brenda Maj 2016/ pas miratimit nga Këshilli Bashkiak	Urdhër i brendshëm KBSh  Përfshirja e detyrave të punonjësve të ST/Sh në përshkrimin e punës	Shqyrtim i dokumentacionit : i Udhëzuesit të Procedurave	ASHMDF, BSH
Përcaktimi i dy personave të kontaktit të ST-Sh në polici	S'ka	Shefat e komisarateve	Drejtori i Policisë Vendore	Brenda Maj 2016	Kërkesë zyrtare drejtuar Policisë	Përfshirja në përshkrimin e punës të punonjësve të policisë të përcaktuar <sup>5</sup>	DPVSH

<sup>5</sup> Veprimtaria e punonjësve të policisë: punën në terren, punën e raportimit, koordinimi brenda strukturave të policisë së shtetit, pjesëmarrjen në takime etj..

Aplikimi i kalendareve / veprimi i skuadrave të terrenit  Gjatë sezonit të verës 3 <sup>6</sup> skuadra	Dy ditë pune në javë për secilin profesionist të përfshirë <sup>7</sup>	Drejtori i DSHSSSHB	Kryetari i BSh	Brenda Qershor 2016	Përfshirja e detyrave të punonjësve të ST/Sh në përshkrimin e punës	Shqyrtimi i raporteve të skuadrave të terrenit, dokumentacionit të rasteve dhe bazës së të dhënave.	BSh
Pajisja e skuadrave të terrenit për veprim (telefon, transport.)	10000 leke/muaj	BSh	Organizatat me të cilat është lidhur marrëveshje	Çdo muaj duke filluar nga Maj 2016	Dokumentat financiarë sipas manualeve/rregulloreve financiare të institucioneve	Vlerësimi i dokumentacionit përkatës	Sipas klauzolave të marrëveshjeve <sup>8</sup>
Pajisja e skuadrave të terrenit për veprim (ofrimin e ujit apo ushqimit )	30000 lekë /muaj / Bashkia	BSh/ Drejtori i DSHSBSH	Organizatat me të cilat është lidhur marrëveshje	Çdo muaj duke filluar nga qershor 2016	Dokumentat financiarë sipas manualeve/rregulloreve financiare të institucioneve	Vlerësimi i dokumentacionit përkatës	Sipas klauzolave të marrëveshjeve
Përgatitja e kalendareve mujore për grupet e terrenit, sipas njësive administrative të bashkisë Shkodër	S'ka	Koordinatori (drejtori) për skuadrat e terrenit	PMF	E premtë e fundit e çdo muaji	Kalendari i përgatitur rregullisht <sup>9</sup>  Kopje janë në DPV, Komisariate. organizata	Shqyrtimi i raporteve të skuadrave të terrenit, dokumentacionit të rasteve dhe bazës së të dhënave.	BSh, Organizatat
<b>Nënobjektivi: Bashkërendimi i identifikuesve të tjerë me skuadrat e terrenit</b>							

<sup>6</sup>Mbase edhe tre në periudha turizmi nese ka?

<sup>7</sup>Detyrat e pjestarëve të skuadrës përfshihen në përshkrimin e punës së punonjësve të shërbimit social të bashkisë , organizatave dhe institucioneve të përfshira me marrëveshje. Veprimtaria e punonjësve të skuadrave të terrenit përfshin : punën në terren, punën e raportimit, pjesmarrjen në takime etj..

<sup>8</sup> Në marrëveshje me organizatat, duhet të përcaktohen edhe përgjegjesisitë dhe çfarë shpenzimesh mbulojnë palët, si edhe mënyrat dhe personat përgjegjës për monitorimin

<sup>9</sup> Forma e kalendarit të veprimtarisë së skuadrave të terrenit

Aktivitetet për arritjen e objektivit	Kosto mujore dhe mbulimi	Përgjegjës kryesorë	Mbështetës	Afati/Shpeshtësia	Treguesit	Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshtësia e monitorimit	Institucioni/përgjegjësia e monitorimit
Afishimi i kontakteve të Skuadrave të Terrenit në sallën operative	S'ka	Drejtoria e policisë vendore	Koordinatori i skuadrave të terrenit	Sa herë është i nevojshëm azhurnimi	Ekzistenca e afishimit  Njoftimet në drejtim të skuadrave të terrenit	Verifikimi në sallat operative	Drejtori i DPVSH, Drejtori i DSHSBSH
Komunikimi dhe bashkërendimi me 129 dhe 116 111	S'ka	BSH Policia vendore	ASHMDF	Komunikimi ndodh për çdo rast të referuar.	Rastet e referuara  Rastet e reagimit	Përballja mes rasteve të referuara dhe atyre të trajtuara	Drejtori i DPVSH, Drejtori i DSHSBSH

**Nënobjekti: Ruajtja e profesionalizmit të punonjësve të skuadrave të terrenit**

Aktivitetet për arritjen e objektivit	Kosto mujore dhe mbulimi	Përgjegjës kryesor	Mbështetës	Afati/Shpeshtësia	Treguesit	Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshtësia e monitorimit	Institucioni/përgjegjësia e monitorimit
Trejnim i Skuadrave të terrenit	50000 për trajnim	BSH	ASHMDF, OSBE, Organizatat	Para fillimit të punës dhe në vazhdim 1 herë në 6 muaj	Dokumetacionet e trajnimeve	Shqyrtimi i dokumetacioneve të trajnimeve, vlerësimi i raporteve axhendë me nevojat	BSH, ASHMDF
Supervizim profesional i skuadrave të terrenit	15 000 muaj	BSH	Organizatrat	Një herë në muaj	Mirëqenia profesionale punonjësve	Pjesëmarrja në këshillim, vlerësimi i këshillimit nga punonjësit e përfshirë	BSH/Organizatrat

**Nënobjekti: Mbledhja, administrimi dhe raportimi i të dhënave**

Aktivitetet për arritjen e objektivit	Kostot dhe mbulimi	Përgjegjës kryesor	Mbështetës	Afati/Shpeshësia	Treguesit	Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshësia e monitorimit	Institucioni/përgjegjësia e monitorimit
Raportimi i rregullt i skuadrave të terrenit	S'ka <sup>10</sup>	Punonjësit e skuadrave të terrenit	PMF	Çdo rast Për Çdo dalje	Numri dhe përmbajtja e formave të vëzhgimit dhe vlerësimit të shpejtë për çdo rast, nr i rasteve të referuara zyrtarisht, sipas udhëzimit	Shqyrtimi i dokumentacionit. Vlerësimi i rasteve të identifikuara me rastet e referuara	BSh, Organizatat
Hedhja e të dhënave në bazën e të dhënave për fëmijët në situatë rruge	S'ka <sup>11</sup>	Koordinatori	Punonjësit e skuadrave të terrenit	Rast pas rasti	Përmbajtja e bazës së të dhënave në raport me format e ST-SH	Rishikimi i Bazës së të dhënave	DSHSBSh
Hartimi i raportit të Koordinatorit të ST-Sh	S'ka	Koordinatori	Punonjësit e skuadrave të terrenit	Çdo 3 muaj	Raportet	Rishikimi i raporteve	DSHSBSh
Ndarja e raportit me, KBSh, Drejtorin Policisë, shefin e komisarariatit , ASHMDF	S'ka	DSHSBSh	Koordinatori	Çdo 3 muaj	Prezenca e raporteve në institucionet përfshira	Verifikimi i ndarjes së raporteve	BSh, ASHMDF

**5.2.2 Koordinimi me bashkitë e tjera për identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge dhe familjeve të tyre**

<sup>10</sup> Përfshirë në përshkrimin e punës të punonjësve të skuadrave të terrenit

<sup>11</sup>Përfshirë në përshkrimin e punës të koordinatorit të skuadrave të terrenit

Aktivitetet për arritjen e objektivit	Kostot dhe mbulimi	Përgjegjës kryesor	Mbështetës	Afati/Shpeshësia	Treguesit	Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshësia e monitorimit	Institucioni/përgjegjësi e monitorimit
2.2. Vendosja e kornizës së bashkëpunimit me bashkive të tjera për zbatimin e planit	S'ka	Bashkia	ASHMDF, organizatat	Brenda qershorit 2016	Nr i rasteve të trajtuara në bashkëpunim	Shqyrtimi i komunikimeve mes punonjësve të shërbimeve sociale përkatëse.	BSH dhe Bashkitë e tjera, ASHMDF

### ***5.2.3 Rritja e aksesueshmërisë për familjet në situatë rruge në shërbimet bazë të arsimit, shëndetësisë, punësimit.***

**Nënobjektiv : Sigurimi i strehimit emergjent të fëmijës dhe trajtimit të menjëhershëm mjekësor**

Aktivitetet për arritjen e objektivit	Kostot dhe mbulimi	Përgjegjës kryesor	Mbështetës	Afati/Shpeshësia	Treguesit	Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshësia e monitorimit	Institucioni/përgjegjësi e monitorimit
Adoptimi i qendrave rezidenciale për pritjen e emergjente të fëmijëve në situatë rruge	S'ka	BSH Qendrat rezidenciale	ASHMDF, MMSR	Brenda maj 2016	Krijimi i hapësirave  Baza materiale e nevojshme	Inspektimi në terren,	ISHPSHS
Caktimi i detyrave për stafin e qendrave rezidenciale për pritjen e emergjencës	S'ka	BSH/ DSHSBSh	MMSR	Sipas rasteve	Azhornimi i përshkrimit të punës për punonjësit qendrave rezidenciale bazuar në udhëzimin e Ministrit të MMSR	Verifikimi i dosjeve të personelit dhe protokolleve të punës	ISHPSHS

Referimi i urgjencave mjekësore	S'ka	ST, qendrat rezideniale	Shërbimet e urgjencës mjekësore	Sipas rasteve	Nr i rasteve të shoqëruara	Verifikimi i dokumentacionit	DSHSBSh /Drejtoria e Shëndetit Publik
<b>Nënobjektiv : Sigurimi i ndihmës për fëmijën dhe familjen</b>							
<b>Aktivitetet për arritjen e objektivit</b>	<b>Kosto mujore dhe mbulimi</b>	<b>Përgjegjës kryesor</b>	<b>Mbështetës</b>	<b>Afati/Shpe shtësia</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshtesia e monitorimit</b>	<b>Institucioni/përgjegjësia e monitorimit</b>
Përgatitja dhe azhurnimi i hartës së shërbimeve efektive	S'ka	BSH SHSRSh	Organizatrat	Çdo 3 muaj	Harta e azhurnuar	Shyqrtimi i dokumnetacionit	BSH, SHSSH
Përgatitja dhe zbatimi planeve individuale të manaxhimit të rastit për çdo fëmijë të referuar.	S'ka	PMF	GTM	Rast pas rasti	Nr i planeve individuale. Përmbajtja e planit individual. Lista e pjesëmarrësve në GTM. Minutat e takimit të GTM.	Verifikimi: rasteve të referuara, kundrejt rasteve të manaxhuara sipas planeve individuale. Plani kundrejt nevojave të fëmijës dhe familjes. Ndjekja e detyrimeve të marra nga anëtarët në takimet e GTM.	DSHSBSh, dhe Drejtoritë përkatëse të anëtarëve të GTM
Ndihmë materiale (ushqimore, higjienike, veshmbathje, medikamente etj) për fëmijët & familjen	70000/muaj	BSH	Organizatrat	Sipas rasteve bazuar në vendimmarrjen e GTM	Nr i rasteve të ndihmuara, minutat e takimit te GTM	Shyqrtimi i dokumnetacionit	BSH, Organizatat
Strehimi i familjeve të fëmijëve në situatë rruge (pagesë qeraje, bonus qeraje, banesë sociale, kredi e zbutur)	100 000 muaj	BSH	Organizatrat	Sipas rasteve bazuar në vendimmarrjen e GTM	Nr i rasteve të ndihmuara, minutat e takimit te GTM	Shyqrtimi i dokumnetacionit	BSH, Organizatat



Rregjistrimi i fëmijëve të parregjistruar	35 000/ muaj	PMF	Bashkia Drejtoria e Policisë Vendore, Organizatrat.	Rast pas rasti	Nr i rasteve të ndjekur	Nr i rasteve të ndjekur kundrejt nr të rasteve të rregjistruar	BSH, Bashkitë e tjera sipas rasteve
Pajisja me kartën e shëndetit , kartelat e vaksinimit	S'ka	PMF	Organizatrat  Qendra shëndetësore	Rast pas rasti	Numri i kartelave shendetesore  Numri i kartelave të vaksinimit		Drejtoria e shëndetit publik, BSH
Informimi, referimi, shoqërimi ose ndërmjetësimi i prindërve dhe të rriturve për punësim dhe pajisja me librezën e papunësisë.	S'ka	DSHSBSH	Bashkia , Drejtoria rajonale e punësimit	Rast pas rasti	Nr. i prindërve dhe të rriturve të referuar/shoqëruar	Shqyrtimi i dokumentacionit	BSH, Zyra Rajonale e Punësimit.
Rregjistrimi i prindërve dhe të rinjve ne programet e formimit profesional dhe nxitjes së punësimit	S'ka	DSHSBSH	ZRP, Organizatrat që ofrojnë shërbime të tilla	Rast pas rasti	Listat, çertifikatat, dosjet individuale.	Shqyrtimi i dokumentacionit, rastet e regjistruara kundrejt atyre që e përfundojnë kursin apo punësohen	BSH, ISHPSHS
Grante të vogla për familjet për vetëpunësim.	Jo ngafondet e Bashkisë për vitin e 17are	Donatorë	Organizatrat  Drejtoria rajonale e punësimit	Rast pas rasti	Nr. I rasteve  Fondet e vëna në dispozicion	Shqyrtimi i dokumentacionit	BSH Donatorë dhe Organizata kontribuese  Shërbimi Kombëtar I Punësimit

Regjistrimi i fëmijëve në shkollë dhe monitorimi i mbarëvajtjes së tyre	S'ka	PMF	DAR Shkodër dhe GTM	I vazhdueshëm	Nr. i femijeve të regjistruar	Shqyrtimi i dokumentacionit/ regjistrat shkollorë	Bashkia, DAR
Regjistrimi i fëmijëve në sistemin parashkollor	S'ka	DSHSBSH	PMF, GTM	I vazhdueshëm	Nr i fëmijëve të regjistruar	Shqyrtimi i dokumentacionit/ nr i fëmijëve të referuar kundrejt nr të fëmijëve të regjistruar, kundrejt nr të fëmijëve që e ndjekin rregullisht	BSH

***5.2.4 Mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge nga shfrytëzimi për punë, lypje, apo rrezik trafikimi si dhe realizimi efektiv i ndjekjes penale për abuzuesit***

<b>Aktivitetet për arritjen e objektivit</b>	<b>Kosto mujore dhe mbulimi</b>	<b>Përgjegjës kryesor</b>	<b>Mbështetës</b>	<b>Afati/Shpeshësia</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e matjes / monitorimit dhe shpeshësia e monitorimit</b>	<b>Institucioni/përgjegjësia e monitorimit</b>
Aplikimi për kërkesë për urdhra mbrojtje për fëmijët	S'ka	Të gjithë sipas ligjit për dhunën në famije	Organizatrat	Sipas rasteve	Numri i kërkesave për urdhër mbrojtje	Urdhret e mbrojtjes	BSH, ASHMDF
Referimi i rasteve të trafikimit sipas PSV-ve	S'ka	PMF	Të gjithë institucionet vendore dhe qendrore sipas PSV-ve	Sipas rasteve	Nr i rasteve	Shqyrtimi i Dokumentacionit të kërkuar sipas PSV-ve , Monitorimi I PSV-ve	DPPSH, Autoriteti Përgjegjës për Viktimat e Trafikimit
Kërkesë për heqje të përgjegjësisë prindërore	S'ka	Prokuroria	PMF dhe GTM	Sipas rasteve	Kërkesat	Shqyrtimi i dokumentacionit	SHSSH

Zhvendosje të kujdestarisë përgjegjësisë prindërore	S'ka	DSHSBSH	GTM, Organizatat dhe institucionet vendore	Sipas rasteve	Nr i rasteve	Shqyrtimi i dokumentacionit	BSH, SHSSH
---	------	---------	--	---------------	--------------	-----------------------------	------------

## 6.Aneks: Kornizë analize për hartimin dhe zbatimin e planit ndihmë për fëmijët dhe familjet në situatë rruge

Situata aktuale e fëmijëve në Shkodër dhe ndërhyrjet mund të përshkruhen në terma të Planit të Veprimit për Fëmijët 2012-2015 Udhëzimit 4 ministror Nr. 10, dhe Udhëzuesit të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Udhëzues i Procedurave për Identifikimin, Ndhimën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situata Rruge” 25.02.2015

### Kategoritë sipas Planit të Veprimit

Kategoria	Numri total i fëmijëve	Burimi i informacionit	Nënkategori	Ndërhyrjet për reduktimin e përjashtimit social	Rezultatet e ndërhyrjeve dhe sfidat
Fëmijët e familjeve më të varfra					
Fëmijët pa kujdes prindëror					
Fëmijë me aftësi të kufizuara					
Fëmijët që detyrohen të					

punojnë					
---------	--	--	--	--	--

### Kategoritë sipas Udhëzimit 4 ministror: niveli i rrezikut

Kategoria	Numri total i fëmijëve	Burimi i informacionit	Nënkategori	Ndërhyrjet për reduktimin e rrezikut	Rezultatet e ndërhyrjeve dhe sfidat
Fëmijë në rrezik të ulët					
Fëmijët në rrezik të mesëm					
Fëmijë në rrezik të lartë					
Fëmijë në rrezik të menjëhershëm <sup>12</sup>					

### Kategoritë sipas Udhëzuesit të dy ministrive: kategoritë e fëmijëve në situatë rruge

Kategoria	Numri total i fëmijëve	Burimi i informacionit	Nënkategori	Ndërhyrjet për reduktimin e situatës së rrugës	Rezultatet e ndërhyrjeve dhe sfidat
Fëmijë në situatë lypje					
Fëmijë të përfshirë në punë informale në rrugë					
Fëmijë që shesin materiale në semafor në kafene, restorane					

<sup>12</sup> Fëmija nuk ka dëshirë të kthehet në shtëpi ose mund të jetojë jashtë shtëpisë ose pa mbikëqyrjen e të rriturve (siç është rasti i fëmijëve që jetojnë në rrugë).

ose në vende të caktuara në anë të rrugës					
Fëmijë që ofrojnë shërbime					
Fëmijë të shfrytëzuar seksualisht për qëllime përfitimë ekonomik					
Fëmijë në konflikt me ligjin					

